

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Kualifikimin Profesional

“BUJQËSI”

Niveli IV i KSHK¹, referuar nivelit IV në KEK²

(1 vjeçar)

Kodi: H-IV-25

Miratoi:

MINISTRI

- 1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2.Korniza Europiane e Kualifikimeve

Tiranë, 2025

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) , 1 vjeçar.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
 3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.
- III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor.**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Programi orientues i provimit përfundimtar**

I. Qëllimet e arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bujqësor dhe blegtoral, si dhe për të vijuar arsimimin dhe formimin në nivele më të larta”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe arsimit të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës dhe përgjegjësisë, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse dhe menaxhuese, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale dhe akademike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në nivelin e III të KSHK, të kualifikimit “Bujqësi”;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MEKI përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të grumbullimit dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse e menaxhuese për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll dhe përshtatshmëri gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në njërin nga profilet mësimore të nivelit III të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të hartojë një plan-bisnesi, që lidhet me veprimtaritë profesionale të një biznesi bujqësor.
- Të kryejë llogaritje ekonomike, që lidhen me veprimtaritë profesionale të një biznesi bujqësor.
- Të menaxhojë burimet materiale, njerëzore dhe financiare gjatë veprimtarive profesionale të një biznesi bujqësor.
- Të interpretojë, plotësojë dhe përgatisë dokumentacion, që lidhet me veprimtaritë profesionale të një biznesi bujqësor.
- Të zbatojë bazën ligjore, që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore.
- Të zbatojë parimet e etikës, gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale bujqësore.
- Të zbatojë standardet teknike në fushën e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe akuakulturë.
- Të zhvillojë marketingun e produkteve bujqësore e blegtorale dhe nënprodukteve të tyre.
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.
- Të menaxhojë fermën bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës.
- Të përdorë pajisjet digjitale për menaxhimin e fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës.
- Të menaxhojë fermën organike bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës.
- Të përdorë pajisjet digjitale për menaxhimin e fermës organike.
- Të mbikëqyrë zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar në fermat bujqësore.
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive bujqësore.
- Të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, si dhe me Certifikatën e teknikut/ menaxherit të mesëm të ekonomive bujqësore. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e bujqësor si teknik, menaxher i mesëm në ferma bujqësore\ blegtorale, si dhe institucione të ndryshme private/ shtetërore, që ushtrojnë aktivitet në sektorin e bujqësisë. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e bujqësisë.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimit profesional në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK (1 vjeçar).

Plani mësimor për kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 13
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	15/16 (480/512)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		Fizikë	1
7		Biologji	2
8		Shkenca sociale	1
9		Histori	1
10		Gjeografi	1
11		Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	1
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	9 (288)
1	L-17-157-22	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-05-198-24	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	1
3	L-14-758-25	Planifikimi dhe organizimi i punës në bujqësi	2
4	L-14-759-25	Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës	3
5	L-14-760-25	Bazat e menaxhimit të fermës organike	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	6 (192)
1	M-14-2215-25	Organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi	33
2	M-14-2216-25	Menaxhimi i prodhimit bujqësor	33
3	M-14-2217-25	Menaxhimi i prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës	33
4	M-14-2218-25	Menaxhimi i prodhimit organik në fermën bujqësore	33
5	M-14-2219-25	Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe	30

		blegtorale	
6	M-38-2220-25	Komunikimi etik dhe profesional në bujqësi	30
		Gjithsej A+B+C	30/31 (960/ 992)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 13, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (32 javë mësimore + 4 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, përbëhet nga 3 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave profesionale dhe menaxheriale, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i përgatitjes së nxënësve në hyrje, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të kualifikimit profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Rekomandohet përdorimi i metodës së “*lojës me role*”, ku nxënësve tu jepen përgjegjësi në kryerjen e funksioneve menaxhuese dhe drejtuese.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna

kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të kualifikimit profesional “Bujqësi”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet përfundimtare.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 13-të, nxënësi i arsimuar në kualifikimin “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, i nënshtrohet provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale (sipas udhëzimeve të MAS dhe MEKI) si dhe Provimit të Praktikës Profesionale të Integruar (sipas udhëzimeve të MEKI).

VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në kualifikimin profesional “Bujqësi”, niveli IV i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale, Çertifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MEKI, këto dëshmi përmbajnë:

a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:

– rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale për çdo vit shkollor

– rezultatet e provimeve përfundimtare të nivelit IV të KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-22) Kl. 13 – 64 orë

• Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të analizojnë veçoritë e etikës dhe komunikimit në kontekstin e veprimtarisë së bizneseve.
- Të kryejnë vlerësimin e mundësive-rreziqeve në kontekstin e konceptimit të idesë së biznesit.
- Të përshkruajnë rëndësinë dhe strukturën e një plani biznesi.
- Të zbatojnë procedurat e regjistrimit dhe përshkruajnë fazat e zhvillimit të biznesit.
- Të konceptojnë strukturën organizative dhe përshkrimet e punës së personelit të një biznesi.
- Të përshkruajnë veçoritë e planifikimit, rekrutimit, seleksionimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore të një biznesi.
- Të analizojnë aspektet e buxhetimit të një biznesi.
- Të kryejnë llogaritje ekonomike në kuadrin e kontabilitetit financiar të një biznesi.
- Të llogarisin kostot dhe çmimet e produkteve e shërbimeve të një biznesi.
- Të analizojnë aspektet e marketingut dhe teknikat e shitjeve në një biznes.
- Të analizojnë rolin dhe teknikat e e-sipërmarrjes në veprimtarinë e bizneseve.
- Të përshkruajnë dhe simulojnë veprimet individuale me bankat, në lidhje me llogaritë, transfertat, kreditë dhe investimet.
- Të analizojnë llojet e siguracioneve personale dhe veprimet që kryhen me to.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.13 - 64 orë

Tema 1	Etika dhe komunikimi në biznes	4 orë
Tema 2	Konceptimi i idesë së biznesit, vlerësimi i mundësive dhe rreziqeve	6 orë
Tema 3	Hartimi i planit të biznesit	6 orë
Tema 4	Procedurat e regjistrimit të biznesit	6 orë
Tema 5	Struktura organizative dhe personeli i biznesit	5 orë
Tema 6	Planifikimi, rekrutimi, seleksionimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore	6 orë
Tema 7	Kostimi dhe çmimi i produkteve dhe shërbimeve	4 orë
Tema 8	Kontabiliteti financiar në kuadrin e biznesit	6 orë
Tema 9	Buxhetimi në biznes	4 orë
Tema 10	Marketingu dhe shitjet në biznes	9 orë
Tema 11	E – sipërmarrja	2 orë
Tema 12	Veprimet individuale me bankat	3 orë
Tema 13	Siguracionet personale	3 orë

2. Lënda “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” (L-05-198-24). Kl. 13 – 32 orë

• Synimet e lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl. 13.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë kuptimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
- Të shpjegojnë objektivat për zhvillim të qëndrueshëm.
- Të shpjegojnë kuptimin për aftësitë e gjelbra në një ekonomi të gjelbër.
- Të shpjegojnë rëndësinë e aftësive digjitale në përballimin e sfidave globale.

- Të analizojnë mjedisin dhe komponentët e tij.
- Të shpjegojnë ekosistemet dhe biodiversitetin.
- Të analizojnë ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre.
- Të shpjegojnë burimet natyrore të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme.
- Të përshkruajë mënyrën e shpjegimit të të dhënave mjedisore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale.
- Të shpjegojnë kuptimi i cikleve të jetës së produktit dhe krijimi i mbetjeve.
- Të përshkruajnë parimet bazë të ekonomisë qarkulluese.
- Të shpjegojnë proceset dhe teknologjitë e riciklimit.
- Të shpjegojnë dhe japin shembuj nga drejtimit profesionale mbi reduktimi, ripërdorimi dhe riciklimin.
- Të hulumtojnë mbi platformat digjitale për programet e menaxhimit të mbetjeve.
- Të shpjegojnë optimizimin e proceseve të riciklimit duke përdorur teknologjinë.
- Të shpjegojnë avantazhet e zgjidhjeve digjitale për mirëmenaxhimin e mbetjeve.
- Të shpjegojnë rëndësinë e ruajtjes, menaxhimit dhe monitorimit digjital të burimeve ujore në drejtimin profesional përkatës.
- Të përshkruajnë praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të ujit në fushën profesionale përkatëse.
- Të dallojnë dhe përdorin sistemet digjitale të monitorimit të përdorimit dhe cilësisë së ujit.
- Të shpjegojnë teknologjitë inteligjente për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit.
- Të përshkruajnë transportin e qëndrueshëm, lëvizshmërinë e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale në drejtimit profesionale përkatës.
- Të dallojnë opsionet alternative të transportit (p.sh., transporti publik, biçikleta, ecje) si dhe përdorimin e mjeteve elektrike në veprimtari të ndryshme profesionale.
- Të dallojnë platformat digjitale për transport të qëndrueshëm si dhe Integrimin e teknologjive inovative në sistemet e transportit publik.
- Të shpjegojnë kuptimin dhe rëndësinë mbi konsumin e qëndrueshëm, tregun digjital dhe marketingun digjital.
- Të dallojnë praktikën etike të konsumit, zgjedhjet e konsumatorëve dhe ndikimet e tyre mjedisore.
- Të shpjegojnë praktikën dhe platformën të qëndrueshme të tregtisë elektronike, si dhe kuptimin për marketingun digjital për promovimin e produkteve eko-miqësore.
- Të përshkruajnë modele të qëndrueshme biznesi bazuar në praktikën të ekonomisë së gjelbër dhe digjitale.
- Të shpjegojnë politikat për zhvillim të qëndrueshëm në fusha të ndryshme profesionale.
- Të shpjegojnë konsideratat etike në qeverisjen digjitale për qëndrueshmëri.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Zhvillimi i qëndrueshëm	3 orë
Tema 2	Bazat e shkencës mjedisore	3 orë
Tema 3	Menaxhimi i mbetjeve, riciklimi dhe zgjidhjet digjitale	6 orë
Tema 4	Ruajtja, menaxhimi dhe monitorimi digjital i burimeve ujore	4 orë
Tema 5	Transporti i qëndrueshëm, lëvizshmëria e zgjuar dhe zgjidhjet digjitale	4 orë
Tema 6	Konsumi i qëndrueshëm, tregu digjital dhe marketingu digjital	4 orë
Tema 7	Sipërmarrja e gjelbër, inovacioni dhe modelet digjitale të biznesit	4 orë
Tema 8	Politika dhe qeverisja për zhvillim të qëndrueshëm	4 orë

3. Lënda “Planifikimi dhe organizimi i punës në bujqësi” (L-14-758-25). Kl. 13 – 64 orë

- **Synimet e lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në bujqësi”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në bujqësi”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të argumentojnë rëndësinë e planifikimit dhe organizimit të aktivitetit bujqësor.
- Të shpjegojnë llojet e proceseve të punës në fermë.
- Të shpjegojnë elementët e planit të prodhimit të fermës.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës në fermë.
- Të shpjegojnë mënyrat e menaxhimit të burimeve materiale.
- Të shpjegojnë procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Të shpjegojnë mënyrat e menaxhimit të burimeve financiare.
- Të shpjegojnë metodat e sigurimit të burimeve materiale dhe financiare.
- Të shpjegojnë përdorimin e materialeve dhe funksionimin mjeteve dhe pajisjeve të punës.
- Të argumentojnë rëndësinë e ndarjes së detyrave të punës në fermë.
- Të shpjegojnë mënyrat e bashkëpunimit me eprorin dhe specialistë të tjerë të bujqësisë.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së realizimit të detyrave në fermë dhe rëndësinë e tyre.
- Të shpjegojnë mënyrat e kontrollit dhe monitorimit të sistemimit dhe pastrimit të vendit të punës.
- Të shpjegojnë format e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike.
- Të shpjegojnë metodat e kontrollit, monitorimit, pastrimit dhe mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve bujqësore.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së kontrollit të gatishmërisë për punë të bazës materiale, mjeteve, pajisjeve dhe makinerive bujqësore.
- Të shpjegojnë procedurat e hartimit të inventarit dhe bilancit të një ferme bujqësore.
- Të argumentojnë regjistrimin e veprimeve ekonomike që realizohen në fermë.
- Të shpjegojnë konceptet e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndikimin e tyre në kapitalin e fermës.
- Të argumentojnë funksionimin e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në fermë.
- Të analizojnë rezultatin e fermës bujqësore.
- Të argumentojnë shlyerjen e detyrimit ndaj shtetit për TVSH-në.
- Të shpjegojnë mënyrat e regjistrimit të blerjeve dhe shitjeve.
- Të shpjegojnë mënyrat e regjistrimeve kontabël në fushën e personelit.
- Të shpjegojnë procedurën e hartimit të bilancit përfundimtar të fermës.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e analizës dhe vlerësimit të mbylljes vjetore.
- Të analizojnë riskun dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre.
- Të argumentojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve digjitale për menaxhimin e fermës.
- Të shpjegojnë formatet e dokumentimit të punës.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit për punën e kryer.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Planifikimi dhe organizimi i punës në bujqësi”, kl.13 - 64 orë.**

Tema 1	Rëndësia e planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve bujqësore	3 orë
Tema 2	Elementët e planit të prodhimit të fermës bujqësore	3 orë

Tema 3	Planifikimi i punës në fermë	3 orë
Tema 4	Menaxhimi i burimeve njerëzore, materiale dhe financiare	6 orë
Tema 5	Ndarja e detyrave dhe organizimi i punës në fermë	5 orë
Tema 6	Kontrolli dhe monitorimi i proceseve të punës në bujqësi	4 orë
Tema 7	Detyrat e kontabilitetit, inventarizimi dhe bilanci në bujqësi	5 orë
Tema 8	Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomike bujqësore	4 orë
Tema 9	Të ardhurat dhe shpenzimet e fermës	3 orë
Tema 10	Llogaritë e rezultatit dhe llogaritë e mallrave	5 orë
Tema 11	Tatimi mbi vlerën e shtuar	4 orë
Tema 12	Regjistrimet për blerjet dhe shitjet	5 orë
Tema 13	Rregjistrimet kontabël në fushën e personelit	3 orë
Tema 14	Mbyllja vjetore dhe analiza e bilancit	5 orë
Tema 15	Risku në bujqësi dhe qëndrimet e fermerit ndaj tij	3 orë
Tema 16	Dokumentimi i punës dhe mënyrat e raportimit	3 orë

4. Lënda “Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës” (L-14-759-25). Kl. 13 – 96 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së sistemit të tokës dhe ndërtimit të brezave në tokat e pjerrëta.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së sistemit të kullimit dhe ujitjes.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të sistemit dhe përgatitjes së tokës.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të mbjelljes së kulturave bujqësore.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së shërbimeve agroteknike në kulturat bujqësore.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të pjekjes së prodhimit.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të vjeljes së prodhimit.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimi dhe transportimit të prodhimit.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të seleksionimit, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së teknologjive së prodhimit në mjedis të mbrojtura.
- Të argumentojnë rëndësinë ekonomike dhe mjedisore të kultivimit të bimëve pa tokë.
- Të shpjegojnë teknologjitë e prodhimit në sistemet e kultivimit pa tokë.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së teknologjive të prodhimit në sistemet e kultivimit pa tokë.
- Të shpjegojnë rëndësinë ekonomike dhe mjekësore të kultivimit të kërpudhave.
- Të shpjegojnë teknologjinë e kultivimit, përgatitjes dhe tregtimit të kërpudhave.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së teknologjive të prodhimit të kërpudhave.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së kryerjes së analizave klimatiko – tokësore.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së përzgjedhjes së bimëve të kopshtarisë.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve dekorative të kopshteve.

- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të krijimit të tapeteve të barit dhe mureve të gjelbërta.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së teknikave të prodhimit të fidanëve të bimëve zbukuruese dhe dekorative.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së përgatitjes së tokës, mbjelljes së farave/fidanëve dhe shërbimeve agroteknike pas mbjelljes së tyre.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të krasitjes dekorative të bimëve të kopshtit.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve teknologjike të kultivimit të bimëve të kopshtit në mjediset e mbrojtura.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të marrjes dhe përgatitjes së produkteve përfundimtare të kopshtarisë.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të seleksionimit, ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve të kopshtarisë.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të magazinimit dhe e ruajtjes së produkteve të kopshtarisë.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së përdorimit të platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit bujqësor.
- Të shpjegojnë përdorimin e pajisjeve digjitale për kontrollin e kushteve të ruajtjes së prodhimeve/produkteve.
- Të argumentojnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbarështimin dhe rritjen e kafshëve.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve teknike dhe higjieno-sanitare të vendstrehimit të kafshëve dhe shpendëve në fermën blegtorale.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së gjendjes shëndetësore dhe mirëmbajtjes së kafshëve dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së procesit të ushqyerjes së kafshëve dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së procesit të riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së trajtimit veterinar të kafshëve dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit dhe transportimit të prodhimit blegtoral.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit blegtoral.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes së bletëve.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes së kategorive të veçanta, si: krimi i mëndafshit, kërmilli, etj.,
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve teknike, higjieno sanitare të baseneve dhe rezervateve.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të rritjes, ushqyerjes dhe riprodhimit të peshkut.
- Të argumentojnë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes së përkujdesjes shëndetësore të peshkut gjatë rritjes.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit e transportimit të peshkut.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit dhe ruajtjes të peshkut.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të rritjes së specieve të tjera (midhje, karkaleca etj.).
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së përdorimit të platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit blegtoral.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës”, kl.13 - 96 orë**

Tema 1	Rëndësia e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtorale dhe të akuakulturës	2 orë
Tema 2	Menaxhimi i proceseve të sistemimit dhe kullimit të tokave	4 orë
Tema 3	Menaxhimi i proceseve të përgatitjes së tokës	6 orë
Tema 4	Menaxhimi i procesit të mbjelljes së kulturave bujqësore	6 orë
Tema 5	Menaxhimi i proceseve të shërbimeve agroteknike në kulturat bujqësore	10 orë
Tema 6	Menaxhimi i proceseve të vjeljes, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit	5 orë
Tema 7	Menaxhimi i proceseve të kultivimit të bimëve pa tokë	5 orë
Tema 8	Menaxhimi i proceseve të kultivimit të kërpudhave	5 orë
Tema 9	Menaxhimi i proceseve të kultivimit të bimëve të kopshtit	10 orë
Tema 10	Teknologjitë digjitale në menaxhimin e fermës bujqësore	4 orë
Tema 11	Menaxhimi i kushteve higjieno-sanitare dhe vendstrehimit të fermës blegtorale	4 orë
Tema 12	Menaxhimi i proceseve të mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve	10 orë
Tema 13	Menaxhimi i proceseve të rritjes së bletëve	6 orë
Tema 14	Menaxhimi i proceseve të rritjes së kategorive të veçanta	5 orë
Tema 15	Menaxhimi i proceseve të rritjes së peshkut	5 orë
Tema 16	Menaxhimi i proceseve të rritjes së specieve të tjera	5 orë
Tema 17	Teknologjitë digjitale në menaxhimin e fermës blegtorale	4 orë

5. Lënda “Bazat e menaxhimit të fermës organike” (L-14-760-25). Kl. 13 – 32 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës organike”, kl. 13.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës organike”, kl.13, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë konceptin “bujqësi organike”.
- Të shpjegojnë rëndësinë e bujqësisë organike, përfitimet shëndetësore, ekologjike, ekonomike dhe social-kulturore.
- Të shpjegojnë rëndësinë e menaxhimit të burimeve natyrore në bujqësinë organike (tokë, ujë, ajër, etj.).
- Të argumentojnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për prodhimin organik.
- Të shpjegojnë rëndësinë e mbikëqyrjes të përdorimit të mjeteve për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e tokës në kultivimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së analizimit të cilësive biologjike të tokës dhe ujit.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së treguesve për vlerësimin e biodiversitetit në fermën organike.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së teknikave të punimeve minimale.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së llojeve të plehrave në plehërimin organik.
- Të shpjegojnë metodat e mbikëqyrjes së përdorimit të plehrave organike, minerale dhe lëndëve shtesë të lejuar në bujqësinë organike.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes për përzgjedhjen e farave/fidanëve në bujqësinë organike.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së proceseve të mbjelljes së kulturave në kultivimin organik.

- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së shërbimeve agroteknike në kultivimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së përdorimit të preparateve të lejuara dhe kontrollin biologjik për mbrojtjen e bimëve.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së proceseve të pjekjes/vjeljes në kultivimin organik.
- Të shpjegojnë mënyrat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit, seleksionimit dhe transportimit të prodhimeve organike bimore.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të magazinimit dhe ruajtjes të prodhimeve organike bimore.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së mbarështimit të kafshëve në fermën organike.
- Të shpjegojnë procedurat e monitorimit të mbarështimit organik të kafshëve dhe akuakulturës organike.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të vendstrehimit të kafshëve dhe shpendëve në mbarështimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve higjieno-sanitare të fermës blegtorale në mbarështimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së mirëqenies ekologjike dhe gjendjes shëndetësore/veterinare të kafshëve dhe shpendëve.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ushqyerjes dhe riprodhimit të kafshëve dhe shpendëve në mbarështimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të grumbullimit dhe transportimit të prodhimit organik të kafshëve dhe shpendëve.
- Të analizojnë teknikat e mbikëqyrjes së kushteve të magazinimit dhe ruajtjes së prodhimeve organike blegtorale.
- Të shpjegojnë mënyrat dhe teknikat e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të prodhimit organik në akuakulturë.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ambalazhimit dhe etiketimit të prodhimeve organike bimore dhe blegtorale.
- Të argumentojnë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për prodhimin organik.
- Të shpjegojnë teknikat e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të certifikimit, etiketimit dhe tregtimit në bujqësinë organike.
- Të analizojnë mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri.
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të platformave, mjeteve, pajisjeve dhe aplikacioneve digjitale në proceset e prodhimit bujqësor organik.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e menaxhimit të fermës organike”, kl.13 - 32 orë**

Tema 1	Kuptimi dhe rëndësia e bujqësisë organike	2 orë
Tema 2	Menaxhimi i burimeve natyrore dhe administrimi i tyre	4 orë
Tema 3	Biodiversitetit në fermën organike	4 orë
Tema 4	Menaxhimi i agroteknologjisë së prodhimit organik në bujqësi	4 orë
Tema 5	Menaxhimi i proceseve të mbarështimit organik të kafshëve	4 orë
Tema 6	Menaxhimi i proceseve të prodhimit organik në akuakulturë	3 orë
Tema 7	Legjislacioni dhe rregullat e certifikimit, etiketimit dhe tregtimit të prodhimeve organike	4 orë
Tema 8	Mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri	4 orë
Tema 9	Teknologjitë digjitale në menaxhimin e fermës organike	3 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1. Moduli: “Organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi”

Kualifikimi: Bujqësi
Niveli: IV i KSHK
Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kod	ORGANIZIMI DHE DOKUMENTIMI I PUNËS NË BUJQËSI	M-14-2215-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis nxënësit me aftësi për të kryer planifikimin, organizimin e punës, menaxhimin e burimeve materiale dhe njerëzore, kryerjen e veprime të blerjeve dhe shitjeve të produkteve bujqësore si dhe dokumentimin dhe raportimin për punën e kryer.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi organizon punën në fermën bujqësore/ blegtorale. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përcaktojë prioritete dhe objektiva për fermën bujqësore/ blegtorale; – të planifikojë punën sipas prioriteteve; – të planifikojë radhën e punës sipas proceseve; – të planifikojë punën në bazë ditore, javore dhe mujore; – të hartojë kalendarin e veprimtarive dhe aktiviteteve në fermës bujqësore/blegtorale; – të bashkëpunojë me kolegët për hartimin e rregullores së brendshme të fermës bujqësore/blegtorale; – të përcaktojë proceset e punës sipas teknologjisë së kultivimit; – të planifikojë furnizimet me mjete, pajisje pune dhe materiale për realizimin e veprimtarive të fermës bujqësore/blegtorale; – të planifikojë furnizimet me lëndë të para dhe ndihmëse; – të planifikojë kryerjen e procesit të inventarizimit dhe bilancit në fermën bujqësore/blegtorale; – të planifikojë përdorimin e teknologjive digjitale në menaxhimin e fermës bujqësore; – të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike; – të ndajë detyrat e stafit sipas kualifikimeve përkatëse; – të hartojë formate për dokumentimin e punës, sipas	

sektorëve;

- të mbikëqyrë realizimin e proceseve të punës sipas detyrave të përcaktuara;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të mbikëqyrë respektimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- të mbikëqyrë respektimin e rregullave të higjienës, të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi mbikëqyr burimet materiale dhe rekrutimin e burimeve njerëzore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbikëqyrë furnizimet me mjete, pajisje pune dhe materiale për realizimin e veprimtarive të fermës bujqësore;
- të mbikëqyrë furnizimet me lëndë të para dhe ndihmëse;
- të mbikëqyrë kryerjen e procesit të inventarizimit, në fermën bujqësore;
- të mbledhë informacion nga të gjithë sektorët lidhur me nevojat për personel;
- të përcaktojë nevojat për personel, sipas analizës së nevojave;
- të përcaktojë dokumentet dhe kriteret e nevojshme për vendet e lira të punës, sipas standardeve të kërkuara (kërkesë punësimi, CV, dokumente vërtetuese të aftësive profesionale dhe personale të kandidatit);
- të përcaktojë mjetet dhe mënyra efektive me të cilat do të kryhet njoftimi për vende pune;
- të publikojë vendet e lira të punës, duke renditur listën e dokumenteve për kandidatët;
- të hartojë kriteret profesionale për vlerësimin e kandidatëve;
- të shqyrtojë dokumentat e kandidatëve për vendet e punës;
- të formulojë pyetësorë dhe formularë për kandidatët që intervistohen;
- të realizojë me profesionalizëm intervistat me kandidatët e përzgjedhur nga seleksionimi i dosjeve;
- të kryejë vlerësim objektiv bazuar në dokumentacionin dhe rezultatin e intervistës;
- të marrë vendim lidhur me pranimin e kandidatëve;
- të publikojë emrat fitues të personelit, sipas sektorëve;

- të prezantojë kandidatët fitues në vendin e punës;
- të përdorë në mënyrë korrekte informacionin mbi bazën ligjore që rregullon marrëdhëniet e punës;
- të negociojë me kandidatët fitues, lidhur me kushtet e punës, pagesën etj.;
- të hartojë kontratën e punës mbështetur në kuadrin ligjor, kodin e punës dhe negociatat paraprahe;
- të nënshkruajë kontratën e punës me personelin e përzgjedhur;
- të identifikojë nevojat për kualifikime të punonjësve, sipas vendeve të punës;
- të ndërtojë kalendarin e trajnimit të vazhduar profesional të punonjësve;
- të realizojë trajnimin e vazhduar profesional të punonjësve;
- të orientojë punonjësit për të ndjekur shkallët e karrierës.
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kryen veprime të blerjeve dhe shitjeve të produkteve bujqësore/ blegtorale.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sistemojë vendin e punës me mjetet dhe pajisjet e duhura për të analizuar dhe vendosur marrëdhënie me furnitorët për blerjet e fermës bujqësore/blegtorale;
- të identifikojë furnitorët potencialë, me të njëjtin objekt veprimtarie dhe të hartojë lista përmbledhëse;
- të identifikojë saktë blerjet, të cilat do të kryhen pranë furnitorëve;
- të përgatisë porositë përkatëse për produktet që do të blihen, në bazë të nevojave të fermës.
- të vendosë marrëdhënie korrekte me furnitorët duke i dokumentuar ato;
RN 2 Nxënësi kontrollon cilësinë e prodhimit blegtoral.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kontrollin e prodhimeve blegtorale;
- të mbikëqyrë dezinfektimin e mjeteve dhe mjedisit të punës, sipas rregullave të HACCP;
- të kontrollojë cilësinë e prodhimit të qumështit sipas procedurës përkatëse;
- të kontrollojë cilësinë e prodhimit të vezëve sipas procedurës përkatëse;
- të kontrollojë cilësinë e prodhimit të mishit sipas procedurës përkatëse;
- të mbikëqyrë vlerësimin e ngjyrës, aromës e shijes së prodhimeve blegtorale, sipas procedurës;
- të mbikëqyrë vlerësimin e konsistencës së prodhimeve blegtorale, sipas procedurës;
- të mbikëqyrë vlerësimin e sigurinë dhe cilësinë e prodhimeve blegtorale, për treguesit organo- shqisorë;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat e HACCP;
- të kryejë llogaritje ekonomike për procesin e sigurimi i cilësisë së prodhimeve blegtorale;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sigurimit të cilësisë së prodhimeve blegtorale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi kontrollon cilësinë e prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kontrollin e

- prodhimit të peshkut, midhjeve, karkalecave;
- të mbikëqyrë dezinfektimin e mjeteve dhe mjedisit të punës, sipas rregullave të HACCP;
- të mbikëqyrë vlerësimin e ngjyrës së prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave, sipas procedurës;
- të mbikëqyrë vlerësimin e aromës dhe shijes së prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave, sipas procedurës;
- të mbikëqyrë vlerësimin e konsistencës së prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave, sipas procedurës;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat e HACCP;
- të kryejë llogaritje ekonomike për procesin e sigurimit të cilësisë së prodhimeve të peshkut, midhjeve dhe karkalecave;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup.
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë sigurimit të cilësisë së prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Nxënësi kontrollon cilësinë e prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin, mjetet e punës për kontrollin e cilësisë së prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit;
- të mbikëqyrë higjienizimin, sterilizimin dhe dezinfektimin e mjeteve, instrumenteve, aparaturave dhe mjedisit të punës, sipas rregullave të HACCP;
- të kontrollojë cilësinë e prodhimit të mjaltit, sipas procedurave përkatëse;
- të mbikëqyrë vlerësimin e ngjyrës, aromës dhe shijes së prodhimit të mjaltit, sipas procedurës;
- të mbikëqyrë vlerësimin e konsistencës së prodhimit të mjaltit, sipas procedurës;
- të kontrollojë trashësinë, peshën dhe gjatësinë e fijes së mëndafshit;
- të kontrollojë elasticitetin dhe forca në tërheqje të fijes së mëndafshit;
- të kontrollojë shkëlqimin natyral të fijes së mëndafshit;
- të kontrollojë ngjyrën dhe njëtrajtshmëria e fijes së mëndafshit;
- të kryejë llogaritje ekonomike për procesin e sigurimit të cilësisë së prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit;

- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, iniciativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të komunikojë me etikë dhe profesionalizëm;
- të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kontrollit të cilësisë së prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe vlerësimin e nxënësve

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral dhe në laboratorin e kontrollit tekniko- kimik.
- Mësuesi/instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit.
- Mësuesi/instruktori i praktikës, duhet të angazhohet në veprimtari konkrete pune për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit.
- Nxënësit duhet të përfshihen në kryerjen e llogaritjeve ekonomike të proceseve të punës.
- Mësuesi/instruktori i praktikës, duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit në repartin e prodhimit.
- Mësuesi/instruktori i praktikës, duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të mirëmbajtjes së enëve, aparaturave, reagentëve dhe pajisjeve përkatëse.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, mjetet, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Repart e prodhimeve bujqësore, blegtorale, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit;
 - Makineri e pajisje të ndryshme për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së prodhimit bujqësor, blegtoral, peshkut, mjaltit dhe fijes së mëndafshit;
 - Spektrofotometër për identifikimin e mbetjeve të pesticideve.
 - Testere rapide për pesticide
 - Refraktometër – për matjen e përqindja e sheqerit.
 - Spektrometra IR për përbërjen e qumështit
 - Tex meter – për trashësinë e fijes.
-

-
- Testues i forcës dhe elasticitetit – tenzometër.
 - Mikroskop për analizë të strukturës së fibrës.
 - Spektrofotometër për shkëlqim dhe ngjyrë.
 - Pajisje për analiza të metaleve të rënda (merkur, kadmium, arsenik).
 - Test për antibiotikë dhe kimikate të ndaluara në mish peshku.
 - udhëzuesa, katalogë, manuale, materiale të shkruara, kushte teknike, kritere dhe vlera reference.
-

6. Moduli: “Komunikimi etik dhe profesional në bujqësi”

Kualifikimi: Bujqësi

Niveli: IV i KSHK

Klasa: 13

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	KOMUNIKIMI ETIK DHE PROFESIONAL NË BUJQËSI	M-38-2220-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të zbatuar rregullat e komunikimit efektiv, etik dhe profesional, si dhe për të realizuar biseda të suksesshme për shitje me klientët në fermat bujqësore.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, të fushës “Bujqësi”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Nxënësi zbaton rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: – të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e punës për të realizuar komunikim efektiv, etik dhe profesional; – të mbikëqyrë procesin e informimit me problemet dhe të rejtat e ditës sipas detyrave dhe përgjegjësisve të përcaktuara në planin e punës; – të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të komunikimit etik dhe profesional sipas Kodit të Etikës; – të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të komunikimit verbal, jo verbal dhe përdorimit të gjuhës së trupit sipas rregullit; – të përdor terminologjinë profesionale në mjedisin e punës, sipas rregullores së brendshme; – të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të vëmendëshme në një komunikim, sipas rregullit; – të komunikojë duke përdorur fjalët e duhura, duke shmangur gabimet retorike, stresin dhe tensionet; – të përdorë gjuhën e trupit për transmetimin e mesazheve; – të bindë bashkëbiseduesit duke përdorur teknika të argumentimit; – të analizojë sjelljen vetjake në biseda; – të marrë dhe përcjellë mesazhe të qarta në komunikim, sipas rregulloreve përkatëse; – të zbatojë rregullat e komunikimit etik profesional në telefon dhe në formë elektronike; – të monitorojë zbatimin e parimeve të punës në grup, sipas rregulloreve përkatëse;	

-
- të mbikëqyrë zgjidhjen e problemeve, mosmarrëveshjeve dhe mendimin kritik në mjedisin e punës sipas rregulloreve përkatëse;
 - të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të komunikimit me bashkëpunëtorët në veprimtarinë profesionale sipas rregullores së brendshme;
 - të zbatojë parimet për barazi gjinore, racore, kulturore, fetare etj, gjatë komunikimit në vendin e punës;
 - të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune;
 - të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
 - të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Nxënësi përdor teknologji bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet digjitale bashkëkohore për realizimin e komunikimit efektiv;
- të marrë dhe të japë mesazhe të qarta gjatë komunikimit nëpërmjet teknologjive bashkëkohore;
- të, realizojë e-mail, videokonferenca, dhe platforma të tjera për të arritur audiencën e duhur në mënyrën më të përshtatshme;
- të përdorë teknologjinë e komunikimit përmes mesazheve të platformave të biznesit si: e-mail, faqet e internetit të furnitorëve të shërbimeve, mediat sociale, si dhe forma të tjera elektronike;
- të komunikojë në kohë reale, për të eliminuar keqkuptimet me bashkëbiseduesin;
- të sigurojë ruajtjen e konfidencialitetit në veprimtarinë profesionale sipas rregullores së brendshme;
- të vendosë dhe të arrijë objektiva gjatë prezantimeve duke përdorur teknologji bashkëkohore;
- të përdorë programe si Word, Excel, PowerPoint për detyra të ngarkuara;
- të përdorë internetin për të kërkuar informacione të besueshme;
- të respektojë rregullat e sigurisë dhe etikës digjitale;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune;
- të demostrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Nxënësi realizon biseda të suksesshme për shitjen e produkteve bujqësore.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet digjitale bashkëkohore për realizimin e komunikimit efektiv gjatë bisedave për shitje;
- të ndërtojë bisedat e shitjes, duke u bazuar në parimet e filozofisë së shitjes;
- të komunikojë si partner dhe jo si kundërshtar me klientin;
- të krijojë atmosferë pozitive gjatë bisedës me klientin;
- të zbatojë teknikat e të pyeturit për të mësuar nevojat e klientëve;
- të dëgjojë klientin në lidhje me nevojat dhe kërkesat;
- të prezantojë avantazhet e produkteve e fermës bujqësore;
- të prezantojë oferta bindëse për klientin;
- të trajtojë kundërshtimet dhe negociimet e çmimit nga klienti, sipas rregullave;
- të zbatojë teknikat e paraqitjes dhe të negociimit të çmimit tek klienti;
- të ndikojë pa presion në vendimet e blerjes së klientit;
- të bindë klientin duke përdorur teknikat e argumentimit;
- të dallojë sinjalet e blerjes nga klienti;
- të përfundojë me sukses procesin e shitjes së produkteve/shërbimeve të klientit;
- të kryejë llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune;
- të demonstrojë përgjegjshmëri, këmbëngulje, inovacion, inisiativë, aftësi për të punuar brenda afateve në mënyrë të pavarur dhe në grup;
- të mbikëqyrë zbatimin e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në ambientet e shkollës, të pajisur me internet dhe mjetet përkatëse për kryerjen e këtyre veprimtarive si dhe mjedise reale të punës në fermat bujqësore/blegtorale.
- Rekomandohen dhe vizita në struktura që ofrojnë shërbime dhe produkte bujqësore/blegtorale.
- Mësuesi duhet të përdorë metodat e simulimit dhe të lojës me role për praktikimin e nxënësve.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe rregullave të komunikimit, prezantimit, dhënies së informacionit, kryerjes së bisedave të

	suksesshme me klientët, si dhe përdorimit të mjeteve dhe teknikave përkatëse. – Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. – Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna. – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të nxëni.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Kabinete në shkollë/mjedise të firmës ushtrimore/fermës bujqësore/blegtorale. – Kompjuter, fotokopje, shërbim interneti dhe programe kompjuterike/aplikacione për të përgatitur dokumentet e nevojshme. – Manuale, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. – Bashkëpunim me biznese reale që zhvillojnë veprimtari në sektorin bujqësor.

X. Programi orientues i provimit përfundimtar

Në përfundim të nivelit në kualifikimin profesional **"Bujqësi", Niveli IV i KSHK**, nxënësit i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar,

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit **" Bujqësi", Niveli IV i KSHK**, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon nxënësit të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu edhe mësuesit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmblendhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t'i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në shkollat e larta apo në arsimin pas të mesëm.

Gjatë përgatitjes së nxënësve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësuesit/instruktorët të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t'i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin profesional **"Bujqësi", Niveli IV i KSHK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të realizojë organizimin dhe dokumentimin e punës në fermën bujqësore/blegtorale.	Detyra 1 - Realizimi i një ose më shumë prej proceseve për organizimin dhe dokumentimin e punës në fermën bujqësore/blegtorale si: – planifikon veprimtaritë bujqësore/blegtorale; – organizon dhe dokumenton punën në fermë	20

		sipas formateve përkatëse; – kryen menaxhimin e burimeve materiale; – kryen procedurat e rekrutimit të personelit; – kryen veprime të blerjeve dhe shitjeve të produkteve bujqësore/blegtorale. – kryen llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune; – mbikëqyr dokumentimin e proceseve të punës dhe raporton për punën e kryer.	
2	Të realizojë menaxhimin e prodhimit bujqësor.	Detyra 2: Realizimi i një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit bujqësor si: – mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së kultivimit të kulturave bujqësore; – mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjellje; – mbikëqyr mbjelljen e farave dhe fidanëve; – mbikëqyr kryerjen e shërbimeve agroteknike gjatë vegetacionit; – mbikëqyr procesin e vjeljes, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit bujqësor; – kryen llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune; – përdor pajisje digjitale për menaxhimin e fermës bujqësore.	20
3	Të realizojë menaxhimin e prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës.	Detyra 3: Realizimi i një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës si: – mbikëqyr teknikat e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve; – mbikëqyr teknikat e rritjes së peshkut; – mbikëqyr teknikat e rritjes së bletëve; – kryen llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune; – përdor pajisje digjitale për menaxhimin e prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës.	20
4	Të realizojë menaxhimin e prodhimit organik në fermën bujqësore.	Detyra 4: Realizimi i një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit organik në fermën bujqësore si: – mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik të kulturave bujqësore; – mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik blegtoral; – mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik në akuakulturë;	20

		– kryen llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune; – përdor pajisje digjitale për menaxhimin e prodhimit organik blegtoral dhe të akuakulturës.	
5	Të realizojë procedurat e sigurimit të cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.	Detyra 5: Realizimi i një ose më shumë prej procedurave të sigurimit të cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale si: – kontrollon cilësinë e prodhimit të kulturave bujqësore; – kontrollon cilësinë e prodhimit blegtoral; – kontrollon cilësinë e prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave; – kontrollon cilësinë e prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit; – kryen llogaritje ekonomike lidhur me këto procese pune.	20
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*detyra pune*”, në ambientet e bazës prodhuese ose fermat afër shkollës.

- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 (tri) orë, në përputhje kjo me Udhëzimin nr. 15. Datë 26.04.2019 “ Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në arsimin dhe formimin profesional”, në fuqi.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.

- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët (organizatorët e provimit) t'i kushtohet vëmendje *“përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të sigurimit teknik, të ruajtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit”* gjatë gjithë kryerjes së detyrës për çdo nxënës.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit, mjeteve dhe pajisjeve të punës, etj.
- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit, i mjeteve dhe pajisjeve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t'u sigurohen mjete, pajisjet si dhe materialet për realizimin e tyre.
- Nxënësit duhet të realizojnë të gjitha etapat për realizimin e detyrave.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kriteret për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri - tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për çdo detyrë.
- Komisioni i provimit për çdo detyrë parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatitë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 1: Nxënësi realizon organizimin dhe dokumentimin e punës në bujqësi.

Kjo detyrë do të realizohet në ambientet e shkollës ose në fermë bujqësore/blegtorale pranë saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë materiale mbi organizimin dhe dokumentimin e punës në bujqësi.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë një ose më shumë prej proceseve për organizimin dhe dokumentimin e punës në fermën bujqësore/blegtorale si: planifikon veprimtaritë bujqësore/blegtorale, organizon dhe dokumenton punën në fermë sipas formateve përkatëse, kryen menaxhimin e burimeve materiale, kryen procedurat e rekrutimit të personelit, kryen veprime të blerjeve dhe shitjeve të produkteve bujqësore/blegtorale, mbikëqyr realizimin e detyrave të planifikuara si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë, duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura, si dhe të kryejë llogaritje ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Materiale fletë format A4, fatura, formularë të ndryshëm model të përgatitura nga mësuesi/instruktori, modele inventari, bilanci, udhëzues, katalogë, rregullore etj.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 2: Nxënësi realizon menaxhimin e prodhimit bujqësor.

Kjo detyrë do të realizohet në ambientet e bazës prodhuese të shkollës ose fermat afër saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë materiale proceseve të realizimit të menaxhimit të prodhimit bujqësor.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit bujqësor si: mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së kultivimit të kulturave bujqësore, mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjellje, mbikëqyr mbjelljen e farave dhe fidanëve, mbikëqyr kryerjen e shërbimeve agroteknike gjatë vegjetacionit, mbikëqyr procesin e vjeljes, magazinimit dhe ruajtjes së prodhimit bujqësor, përdor pajisje digjitale për menaxhimin e fermës bujqësore si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Sensorë të lagështisë së tokës (Soil Moisture Sensors)
- Stacione meteorologjike portative
- Makineri për mbjellje automatike.
- Sisteme automatike ujitjeje
- AgriTech për planifikim të sezonit, menaxhimin e inputeve, gjurmimin e rendimentit dhe raportim.
- Sisteme ERP për bujqësi – ndihmojnë në menaxhimin financiar, magazinën dhe logjistikën.
- Mjete, pajisje dhe platëforma digjitale për menaxhimin e fermës bujqësore.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 3: Nxënësi realizon menaxhimin e prodhimit blegtoral.** Kjo detyrë do të realizohet në ambientet e fermës blegtorale të shkollës ose fermat afër saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë materiale proceseve të realizimit të menaxhimit të prodhimit blegtoral.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës si: mbikëqyr teknikat e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve, mbikëqyr teknikat e rritjes së peshkut, mbikëqyr teknikat e rritjes së bletëve, përdor pajisje digjitale për menaxhimin e prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Pajisje për ushqim, ujitje dhe kujdes të kafshëve (inkubatorë, makina ushqimi, vegla pastrimi);
- Mjete për bletari (kosherë, spatula, kostume mbrojtëse);
- Pajisje teknologjike për monitorim (sensorë, kamera, GPS);
- Shpërndarës automatik të ushqimit (fëders) – për ushqyerje të rregullt.
- Peshore për ushqim – për matjen e saktë të sasisë.
- Senzorë për oksigjen të tretur) – për monitorim të vazhdueshëm.
- Rrjeta dore.
- Mjete, pajisje dhe platëforma digjitale për menaxhimin e fermës blegtorale.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Udhëzime për realizimin e **Detyrës 4: Nxënësi realizon menaxhimin e prodhimit organik në fermën bujqësore.**

Kjo detyrë do të realizohet në ambjentet e bazës prodhuese të shkollës ose fermat afër saj.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë materiale mbi zbatimin e teknikave të prodhimit të produkteve organike në fermat bujqësore.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë një ose më shumë prej proceseve të menaxhimit të prodhimit organik në fermën bujqësore si: mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik të kulturave bujqësore, mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik

blegtoral, mbikëqyr zbatimin e agroteknologjisë së prodhimit organik në akuakulturë, përdor pajisje digjitale për menaxhimin e prodhimit organik blegtoral dhe të akuakulturës si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Lëndët e para dhe ndihmëse të nevojshme për realizimin e detyrës.
- Sensorë të lagështisë së tokës (Soil Moisture Sensors)
- Makineri për mbjellje automatike.
- Sisteme automatike ujitjeje
- AgriTech për planifikim të sezonit, menaxhimin e inputeve, gjurmimin e rendimentit dhe raportim.
- Sisteme ERP për bujqësi – ndihmojnë në menaxhimin financiar, magazinën dhe logjistikën.
- Mjete, pajisje dhe platëforma digjitale për menaxhimin e fermës bujqësore.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 5: Nxënësi realizon procedurat e sigurimit të cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Komisioni i provimit paraprakisht ka përgatitur tezat të cilat përmbajnë materiale mbi procedurat e sigurimit të cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë një ose më shumë prej procedurave të sigurimit të cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale si: kontrollon cilësinë e prodhimit të kulturave bujqësore, kontrollon cilësinë e prodhimit blegtoral, kontrollon cilësinë e prodhimit të peshkut, midhjeve dhe karkalecave kontrollon cilësinë e prodhimit të mjaltit dhe të fijes së mëndafshit si dhe zbatimin e kërkesave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, sipas tezës, duke përdorur mjetet dhe pajisjet e punës sipas procesit.

Në fund të procesit të punës nxënësi duhet t'a prezantojë atë duke zbatuar rregullat e komunikimit me etikë profesionale, të inventarizojë mjetet dhe pajisjet e përdorura si dhe të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Mjete dhe pajisje pune të nevojshme për realizimin e proceseve.
- Spektrofotometër për analizë kimike (pH, përmbajtje nitratesh, fosfatesh etj.)
- Sonda për marrje mostrash nga toka

- Teste rapide për analizën e përmbajtjes së nitratit në ujë
- Kit-e portative për analizë të mbetjeve të pesticideve
- Laboratorë portativë për teste në terren (p.sh. për produkte organike)
- Laboratorë të certifikuar për analiza të avancuara në laborator.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit. Gjatë bashkëbisedimit profesional, komisioni drejton pyetjet veçanërisht në pikat kritike. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe.

Ndryshimet në skeletkurrikulin “Bujqësi” Niveli IV i KSHK

Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në drejtimin mësimor “Bujqësi”, niveli IV i KSHK.

- Të menaxhojë fermën bujqësore, blegtoriale dhe të akuakulturës.
- Të menaxhojë fermën organike bujqësore.
- Të menaxhojë fermën bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet paisjeve digjitale.
- Të menaxhojë fermën organik bujqësor nëpërmjet paisjeve digjitale.
- Të mbikëqyrë menaxhimin e prodhimit bujqësor.
- Të mbikëqyrë menaxhimin e prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës.
- Të mbikëqyrë vlerësimin e tokës bujqësore për prodhim organik.
- Të mbikëqyrë zbatimin e masave të mbrojtjes së integruar në fermat bujqësore.
- Të menaxhojë prodhimin bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet paisjeve digjitale.
- Të mbikëqyrë menaxhimin e prodhimit organik në fermën bujqësore.
- Të menaxhojë prodhimin organik në fermë bujqësor nëpërmjet paisjeve digjitale.

Tabela e lëndëve:

Lënda: “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi” / “**Planifikimi dhe organizimi i punës në fermën bujqësore**”. Nga 96 orë është bërë 68 orë, kemi ndryshime përmbajtësore, në synime dhe temat mësimore. Ka ndryshime edhe në numrin e orëve për temat.

Lënda: “Bazat e menaxhimit të fermës bujqësore, blegtoriale dhe të akuakulturës” me 96 orë është lëndë e re.

Lënda: “Bazat e bujqësisë organike” / “Bazat e menaxhimit të fermës organike” nga 64 orë është bërë 32 orë kemi ndryshime përmbajtësore, në synime dhe tema. Ka ndryshime edhe në numrin e orëve për temat.

Module të detyruar të praktikës profesionale

Moduli: “Organizimi dhe dokumentimi i punës në bujqësi” është hartuar modul i ri

Moduli: “Menaxhimi i prodhimit bujqësor” është hartuar modul i ri

Moduli: “Menaxhimi i prodhimit blegtoral dhe të akuakulturës” është hartuar modul i ri

Moduli: “Menaxhimi i prodhimit organik në fermën bujqësore” është hartuar modul i ri

Moduli: “Sigurimi i cilësisë së prodhimit bujqësor blegtoral” është hartuar modul i ri

Moduli: “Komunikimi etik dhe professional” është hartuar modul i ri.